




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 22 korrik 2022

Nga: Ymer Fejzullahu, Kryesues i Bordit të ZRRE-së
Për: Z. Mesut Serhat Dinc, Drejtor Menaxhues KESCO sh.a
Kopje: Znj. Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë



Lënda: Kërkesë për shqyrtim të jashtëzakonshëm për të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 19 korrik 2022 ka pranuar nga Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU) kërkesën për shqyrtim të jashtëzakonshëm të të hyrave të lejuara maksimale. Në kërkesën e saj FSHU thekson se në mungesë të rimbursimit të mjeteve të subvencionit nga Qeveria e Republikës së Kosovës prej 31 milion eurove për periudhën 9 shkurt – 30 qershor 2022, është tejkaluar pragu i materialitetit prej 5% siç përcaktohet në Rregullën e të Hyrave të FSHU-së, duke mundur kështu hapjen e shqyrtimit të jashtëzakonshëm.

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të saja, ZRRE në vazhdimësi ka shpreh gatitshmëri dhe ka ofruar mbështetje në kuadër të kompetencave të saja për të përmblyllur me sukses procesin e disbursimit të subvencionit. Konkretisht pas kërkesës së FSHU-së të datës 22 prill 2022, ZRRE me datë 26 prill 2022 ka adresuar këtë çështje tek Ministria e Ekonomisë dhe Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, duke kërkuar që ministritë përkatëse të trajtojnë me prioritet këtë çështje, në mënyrë që të ruhet siguria dhe përbalueshmëria e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët e rregulluar. Përkundër këtyre veprimeve të ndërmarra nga Rregullatori, Qeveria e Republikës së Kosovës akoma nuk ka përmbushur obligimin e saj për subvencionimin e energjisë elektrike.

Në kuadër të obligimeve ligjore, Rregullatori ka mandat që të kujdeset për sigurinë e furnizimit me energji elektrike, ruajtjen e sistemit elektro-energjetik nga ndonjë dëmtim i pariparueshëm. Prandaj, duke qenë se një situatë e tillë për shkak të mos disbursimit të subvencionit mund rrezikojë sigurinë e furnizimit me energji elektrike, ngase operatorët e sektorit të energjisë janë duke i ekspozuar ndaj rrezikut të lartë të likuiditetit financiar, Rregullatori kërkon nga FSHU që konform dispozitave të Shtojcës 4 të Rregullës për të hyrat e FSHU-së, brenda afatit 20 ditor t'i dërgojë ZRRE-së raportin për ndikimin financiar nga ngjarja e jashtëzakonshme.

Me respekt,


Ymer Fejzullahu

Kryesues i Bordit të ZRRE-së

